



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER VALBONA SH. SELIMI
ADRESA NR.3, HOXHA TASIM,
NR.292
TEL: 695761243


KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1546

Nr. koleksioni: 517

Tirane më 28/02/2023



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2023052730055063918



KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

Sot, më datë 28/02/2023, para meje Notere VALBONA SH. SELIMI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, ne zyrën time në adresën Tirane, NR.3, HOXHA TASIM, NR.292, u paraqiten personalisht:

SHITES: Xhenis Angjeli (emri i vajzërisë Xhabafti), atësia Arben, amësia Miranda, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane dhe banuese në TIRANË, me adresë Nikolla Tupe; Nd. 44; H. 2; Ap. 8; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 25/05/1995, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me dokument identiteti me nr. personal J55525072W.

SHITES: Eral Myftaraj, atësia Hiqmet, amësia Makbule, shtetas Shqiptar, lindur në Gramsh dhe banues në TIRANË, me adresë Lord Bajron; Nd. 40; H. 3; Njësia Administrative Nr. 11; Njësia Bashkiake Nr. 11; 1026; Tiranë, lindur më 25/10/1975, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me me dokument identiteti me nr. personal H51025125P.

BLERES: Borana Baci, atësia Feliks, amësia Nevila, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane dhe banuese në TIRANË, me adresë Grigor Heba; Nd. 11; H. 1; Ap. 14; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 24/03/1991, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me pasaporte me nr. personal J15324072H.

PALET BIET DAKORD SA VIJON:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1 Përkufizime

Termat me shkronja te medha shtypi ne kete Marreveshjeje do te kene kuptimin e percaktuar ne vijim:

"**Barrë**" nënkupton cdo pretendim, interes apo e drejte e cdo individi (duke përfshirë cdo të drejtë për të blere, mundesi per te blere ne te ardhmen apo te drejte parablerjeje) ose cdo hipoteke, kolateral, peng, cedim, kufizim, interes sigurues (duke përfshirë edhe ato të krijuar me ligj), ruajte te drejte ose cdo marrveshje sigurimi apo marreveshje ose rregullim tjetër barresues apo marreveshje qeraje, qeraje financiare, shitje me kredi apo marreveshje tjeter per pagim me rezerve;


"**QKB**" nënkupton Qendra Kombëtare e Biznesit, organi publik Shqiptar që ka kompetencën e mbajtjes se dhe regjistrimeve në regjistrin tregtar të Shqipërisë.

2. TRANSFERIMI I KUOTAVE

2.1 Shitja e Kuotave

2.1.1 Ne perputhje me kushtet e parashikuara ne kete Marrëveshjeje, Bleresi blen nga Znj. Xhenis Xhabafti dhe Z. Eral Myftaraj nga nje pjese te kuotes qe secili prej tyre zoteron ne shoqerine shqiptare "Albanian Archives" sh.p.k. (me poshte referuar "**Shoqeria**") me NIPT L92023007L, të lira dhe të parënduara me ndonjë Barre.

2.1.2 Konkretisht, **Znj. Xhenis Xhabafti** dhe **Z. Eral Myftaraj** zotërojnë secili 40% te kapitalit themeltar te Shoqerise. Secili prej tyre i tranferon Bleresit 10% te kapitalit themeltar te Shoqerise. Si rrjedhoje e ketij transaksioni **Znj. Xhenis Angjeli** dhe **Z. Eral Myftaraj** do te zotërojnë secili 30% te kapitalit themeltar te Shoqerise, dhe Bleresi do te zoteroje 20% te kapitalit themeltar te Shoqerise.





2.1.3 Titulli i pronësive mbi kuoten që shitet do të transferohet tek Blerësi me lidhjen e kësaj kontrate, dhe kuota shitet së bashku me të gjitha të drejtat dhe perfitimet që lidhen me to ose që u jepen atyre deri në këto date (duke përfshirë të drejtën për të marrë gjithë dividendin, shpërndarjen ose ndonjë kthim të kapitalit të deklaruar, të paguar ose të realizuar nga Shoqëria deri me sot).

2.2 Cmimi i Blerjes

Blerësi i paguan Shitësve për blerjen e kuotave një shumë të barabartë me 10.000 Lek secilit ("Cmimi i Blerjes").

2.3 Pagesa e Çmimit të Blerjes

Palet deklarojnë se Blerësi e ka shlyer të plotë Cmimin e Blerjes me lidhjen e kësaj Marrëveshje.

3. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

3.1 Marrëveshja dhe Amendamentet

3.1.1 Kjo Marrëveshje zhvleftëson çdo marrëveshje të mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshje.

3.1.2 Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshje është i vlefshëm vetëm nëse është bërë me shkrim dhe është nënshkruar prej ose në emër të secilës prej Palëve dhe i referohet në mënyrë specifike kësaj Marrëveshje.

3.2 Transferimi

Kjo Marrëveshje do të jetë e detyrueshme për zbatim dhe do të zbatohet edhe prej pasardhësve të Palëve por nuk do të jetë e transferueshme pa miratimin paraprak me shkrim të Palëve të tjera.

4. LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Kjo marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare. Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me vlefshmërinë, interpretimin apo zbatimin e Marrëveshjes të zgjidhet nëpërmjet Gjyqates së Rrethit Gjyqesor Tirane.

* * *

Akti u redaktua dhe u nënshkrua në zyrën time konform vullnetit të plotë të paleve të cileve pasi ua lexova marrëveshjen dhe i shpjegova efektet ligjore dhe pasi deklaruan se u kuptua prej tyre, e nënshkruan rregullisht para meje noteres dhe une Noterja vertetoj nënshkrimin e tyre konform Ligjit.

Eral Myftaraj

Borana Baci

Xhenis Angjeli (emri i vajzërisë Xhabafti)

Noter Valbona Selimi